



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2539 prot.

Fushë-Arrëz, më 25.08.2025

PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE

“MBI DRAFTIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025-2028 NË
BASHKINË FUSHË-ARRËZ”

I mbajtur sot, më 25.08.2025.

Vendi: Në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Ora:10:00

Në takim marrin pjesë:

Mikel Qafa, Zëvendëskryetar Bashkie;

Altin Engjëlli, Specialist për Arsimin në Bashki;

Albina Prenga, Specialiste e IT në bashki;

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

Të pranishëm në këtë konsultë janë këshilltarë të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të administratës së bashkisë, institucioneve vendore, shoqërisë civile, grupe interesi dhe banorë të bashkisë.



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, përshëndet dhe falenderon të pranishmit në takim si dhe bën prezantimin e ekipit të bashkisë dhe të temës së diskutimit të dëgjësës publike mbi “Draftin e Planit të Arsimit Parauniversitar në Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028”.

Fjalën hapëse e mbajti **Mikel Qafa**, Zëvendëskryetar Bashkisë:

Të nderuar qytetarë, prindër, mësues, përfaqësues të institucioneve arsimore dhe të administratës!

Është kënaqësi e madhe të jemi sot së bashku për të prezantuar draftin e Planit për Arsimin Parauniversitar të Bashkisë për periudhën 2025–2028. Ky dokument strategjik është hartuar me bindjen se arsimi është themeli i zhvillimit të qëndrueshëm, i barazisë së mundësive dhe i forcimit të komunitetit tonë.

Ky plan synon të adresojë sfidat aktuale në infrastrukturën shkollore, cilësinë e mësimdhënies, përfshirjen e fëmijëve nga

të gjitha shtresat shoqërore, si dhe nevojën për një shkollë bashkëkohore që përgatit qytetarë të përgjegjshëm dhe të aftë për tregun e së ardhmes.

Përmes tij, kemi vendosur prioritete të qarta: modernizimin e ambienteve mësimore, zgjerimin e aksesit në arsimin parashkollor dhe forcimin e partneritetit midis shkollës, familjes dhe komunitetit.

Ky dokument nuk është përfundimtar, është një draft që kërkon të marrë mendimet, sugjerimet dhe kritikën tuaj, sepse vetëm përmes një procesi të hapur e gjithëpërfshirës mund të ndërtojmë një plan të suksesshëm dhe të zbatueshëm.

Jam i bindur se nga kjo dëgjësë do të dalim me ide dhe propozime konkrete, që do ta bëjnë Planin 2025–2028 një udhërrëfyes të fortë për një arsim parauniversitar më cilësor, më të barabartë dhe më afër nevojave të fëmijëve tanë.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!



Në vazhdim fjalën e merr, **Altin Engjëlli**, Specialist për Arsimin në Bashki:



Faleminderit dhe mirë se keni ardhë në këtë dëgjese konsultative ku pjesëmarrja tregon se interesi juaj dhe padyshim besimi ndaj sektorëve të pushtetit vendor po vjen duke u rritur. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë mendimet dhe rekomandimet tuaja lidhur draftin e Planit për Arsimin Parauniversitar 2025-2028 në Bashkinë Fushë-Arrëz”.

Plani i Arsimit Parauniversitar 2025–2028 për Bashkinë Fushe-Arrez është një dokument strategjik i domosdoshëm që synon të orientojë zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në territorin e Bashkisë për tre vitet e ardhshme. Hartimi i tij është rezultat i një analize të thelluar të situatës aktuale, tendencave demografike, nevojave komunitare dhe sfidave ekzistuese në arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm. Ky dokument është një instrument thelbësor planifikimi për strukturat vendimmarrëse dhe administrative për të garantuar një arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Fushë - Arrëz.

Plani ofron një analizë të detajuar për të gjithë Bashkinë Fushë-Arrëz në lidhje me arsimin parauniversitar. Në total, në këtë bashki funksionojnë 9 kopshte publike, 3 shkolla 9-vjeçare publike, 1 shkollë e mesme publike. Gjithsej në vitin 2025 bashkia menaxhon 111 punonjës që i takojnë sistemit parauniversitar të arsimit, nga këto 107 edukativ dhe 4 punonjës ndihmës. Në raport me fëmijët e lindur 3-6 vjeç në Bashkinë Fushe - Arrez fëmijët që frekuentojnë arsimin parashkollor janë rreth 75% e fëmijëve të kësaj moshe, dhe fëmijë që ende mbeten jashtë sistemit janë rreth 25%. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Fushe - Arrez.

Bashkia menaxhon 24 godina arsimore nga te cilat 16 prej tyre kanë nevojë për rikonstrukcion ose zgjerim për shkak të infrastrukturës së amortizuar. Gjithashtu vlen të theksohet se përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore ka luajtur rol dhe në shtimin e shkollave qendra komunitare që tani në Bashkinë Fushe - Arrez janë 3 shkolla nga të cilat 2 9 - vjeçare dhe 1 shkolle e mesme.

Vizioni i planit është të garantojmë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz

Objektivat strategjike përfshijnë:

- Rritja e aksesit në arsimin parauniversitar për të gjithë fëmijët e Bashkisë Fushe-arrez, me fokus në zonat më të pafavorizuara dhe grupet vulnerabël.
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përdorimi i metodave bashkëkohore në procesin e mësimdhënies
- Forcimi i kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave për të siguruar një menaxhim efikas dhe inovativ.
- Mbështetjen për fëmijët me aftësi ndryshe dhe nga grupe të marginalizuara,
- Forcimin e rolit të shkollës si qendër komunitare.

Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë Fushe-Arrez është ndërtuar në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026, duke siguruar që objektivat dhe masat e ndërmarra në nivel lokal të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar të arsimit në nivel kombëtar. Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Fushe-arrez dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me Arsimin Parauniversitar.

Konkretisht nëpërmjet planit synohet të realizohet :

- Zgjerimi i rrjetit të kopshteve për të përfshirë më shumë fëmijë në arsimin parashkollor.
- Masa për parandalimin e braktisjes shkollore në zonat periferike dhe komunitetet vulnerabël.
- Trajnime të vazhdueshme për mësuesit në metodologji bashkëkohore dhe përdorim të teknologjisë.
- Pajisja e shkollave me laboratorë, mjete didaktike moderne dhe lidhje të qëndrueshme me internet.
- Parashikimi i fondeve në buxhetin vendor për programe trajnuese dhe certifikime të stafit mësimor e ndihmës.
- Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit midis institucioneve arsimore për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira.

Kjo përputhje i jep Planit Vendor një qasje të integruar dhe garanton që çdo ndërhyrje në territorin e Bashkisë Fushë - Arrëz është pjesë e një vizioni më të gjerë kombëtar për një sistem arsimor më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

Plani i investimeve kapitale i Bashkisë Fushë - Arrëz për Arsimin Parauniversitar për periudhën 2026–2028 është ndërtuar mbi objektivin e përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese, ndërtimit të godinave të reja, pajisjes së institucioneve arsimore me orendi dhe logjistikë moderne, si dhe garantimit të kushteve të sigurta për fëmijët dhe të rinjtë në procesin edukativ. Të gjitha projektet e planifikuara do të financohen nga buxheti vendor i bashkisë.

Faleminderit!



Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak
Fushë-Arrëz:

Meqenëse nuk ka diskutime dëgjesa mbyllet
këtu duke ju falenderuar për përkushtimin
dhe angazhimin tuaj!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
DRAFTI I PLANIT VENDOR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025-2028
PËR BASHKINË FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Mirjeta	Irroku	F - Arrëz	QSNMN	
2.	Jone	Memari	F. Arrëz	QSNMN	
3.	Age	Doda	F. Arrëz	QSNMN	
4.	Violeta	Vucaj	Fushë-Arrëz	INSP. P.B	
5.	Elis	MIRIJA	KRYETARI	Ekonomist	
6.	Dodë	Pera	Q. Meli	Ing. Pyzën	
7.	Nikolin	Qafa	Fushë-Arrëz	P.P. Bashkiake	
8.	Entela	Pepa	fushë - Arrëz	Përgj. Auditit	
9.	LULETA	SOBA	FUSHE - ARRËZ	Spec. Auditit	
10.	Silvana	Gjergji	F. Arrëz	Edukatore	
11.	Age	Qafa	F. Arrëz	Drejtoreshë	
12.	Alërdita	Brakaj	F.A.	Edukatore	
13.	Edmonda	Delio	F.A.	Edukatore	
14.	Dalina	Prenga	F. Arrëz	QSNMN	
15.	Dalina	Curri	Fushë-Arrëz	QSNMN	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
DRAFTI I PLANIT VENDOR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025-2028
PËR BASHKINË FUSHË-ARRËZ"

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Migjesho	Isrohu	F - A	QSMNN	
2.	Age	Doda	F. A	QSNNN	
3.	Tone	Mema	F. A.	QSNNN	
4.	Afërdita	Brabaj	F. Arrëz	Edukatore	
5.	Silvana	Gjergji	F. Arrëz	Edukatore	
6.	Age	Rafa	F. Arrëz	Drejtoneshë	
7.	Edmonda	Delio	F. Arrëz	Edukatore	
8.	Dalina	Curri	F. Arrëz	QSNNN	
9.	Dalina	Prença	Fushë Arrëz	QSNNN	
10.	Tonim	Mhilli	F.A.	Metanik	
11.	Monte	Wikolli	F. Arrëz	QSNNN	
12.	Armen	Noda	FA	DAPK	
13.	Viktor	Mikuli	F. ARRËZ	INJ. PROFESION	
14.	Albina	Prença	F. Arrëz	Specialiste IT	
15.	Valbona	Milla	F. Arrëz	Specialiste KB.	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
DRAFTI I PLANIT VENDOR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025-2028
PËR BASHKINË FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Tonin	Mhilli	F. Arrëz	Mekanik	
2.	Arina	Simoni	Fushë-Arrëz	Drejtoreshë	
3.	Marie	Moring	F. Arrëz	Sp. Migrimit	
4.	Lindita	Lleshi			
5.	Albi	Gjergjell	Fushë-Arrëz	Soc. QRSK	
6.	Flodiana	Pjetra	Fushë - Arrëz	Prgj. Gjendja Civile	
7.	Gjoko	Mitcolli	Fushë - Arrëz	Bashkia	
8.	Redona	Hasani	Fushë - Arrëz	Prgj. Turiste	
9.	Desora	Ilaca	Fushë - Arrëz	Sp. Bujqësi dhe Bujqësi	
10.	Marijana	Laska	Fushë - Arrëz	Sp. Protokolli	
11.	Sidorela	Katroschi	B. F. Arrëz	Drejtoreshë e Çështjeve Sociale	
12.	Lindita	Lleshi	Bashkia F.A.	Specialist e Çështjeve Sociale	
13.	Naze	Selima	Bashkia F-Arrëz	Shkretare e KB	
14.					
15.					